



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:031494

Datë: 27.08.2024

Numri i dokumentit: 06089752

**P.nr. 2024:031495**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NËFERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal**, gjyqtari i vetëm gjykues Adem Shabani me procesmbajtësen Zyrtaren Ligjore Arbelinda Tahiri, në lëndën penale kundër të akuzuarit Rr.M., nga fshati ....., Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 06/L-074, duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1362/2023 të datës 26.01.2024, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 26.08.2024, në prezencë të Prokurorit të shtetit Mimoza Sylja Hyseni, të akuzuarit Rr.M., mori dhe publikisht shpalli, ndërsa datën 27.08.2024 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **Rr.M.**, nga fshati ....., Komuna Ferizaj, i lindur me datë ....., nga i ati R., e ëma Sh., të vajzërisë V., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, punëtor fizik, i martuar baba i një fëmije, punëtor fizik, i gjendjes së dobët ekonomike me numër personal ....., mbrohet në liri,-

### Ë S H T Ë F A J T O R

#### SEPSE:

- Me 6 shtator të vitit 2023, rreth orës 13:50, në vendin e quajtur “....” në fshatin ....., Komuna Ferizaj, i pandehuri me qellim të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshme e që vetit t’i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Pyjet e Kosovës nr. 08/L-137, në atë mënyrë që shkon tek vendi i lartpërmendur dhe me sharrë motorike i prenë 20 cope trungje të llojit “Ahu” me vëllim të përgjithshëm prej 3.80 metër kub, ku me vete kishte edhe mjetin transportues traktor “IMT ...” së bashku me

rimorkio, me ç' rast Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj, i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 581.40 Euro,-

**- me çka ka kryer veprën penale; Vjedhje Pylli nga neni 349 paragrafi 1 , të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074.**

Gjykata Themelore në Prizren dega Suharekë në bazë të neneve 7, 17, 21, 38, 39 par.1 nënpar.1.1, 43, 69, 70, 349 par. 1 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 06/L-074,neneve, 364, 365, 449 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.6 dhe 2.9, 462 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK) 08/L-032, e

## **G J Y K O N**

Të akuzuarit **RR.M.**, i Shqipton dënim me gjobë në shumën prej 200 Euro ( dyqind euro) të cilën duhet ta paguaj,15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në çoftë së i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim duke e zëvendësuar dënimin me gjobë në dënimin me burgim, ashtu që 1 (një) ditë burgim llogaritet me 20 € (njëzet) euro gjobë, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së,.

Obligohet i akuzuari të paguaj-shpenzimet e procedurës - në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30 Euro ( tridhjetë euro), në emër të taksës për kompensim të viktimave të krimit shumën prej 20 € (njëzetë euro), të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyruar.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro ( tridhjetë euro), në emër të taksës për kompensim të viktimave të krimit shumën prej 20 € (njëzetë euro), të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyruar.

Pala e dëmtuar: Drejtoria për Bujqësi Pylltari, dhe Zhvillim Rural Komuna Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

Prokurori i shtetit i Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP/II.nr.1362/2023 të datës 26.01.2024, e ka akuzuar Rr.M., nga fshati ..., Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 06/L-074.

Gjykata me datën 04.06.2024 ka caktuar shqyrtimin fillestar por i akuzuari nuk ishte paraqitur në seancat gjyqësore edhe pse e kishte pranuar ftesën dhe mos ardhjet nuk i ka arsyetuar dhe gjykata për seancat e radhës për datën 04.06.2024 ka lëshuar Urdhër arrest për të akuzuarit Stacionit Policor në Ferizaj, që i akuzuari të sillet në Gjykatë e datën 02.07.2024 por nuk është sjellë pra nuk është zbatuar urdhëresa dhe Gjykata nuk ka pranuar ndonjë njoftim për mos zbatimin e s duhet të sillet në Gjyaj dhe Gjykata seancë gjyqësore e ka shtyrë në kohë të pa caktuar por të pandehurin Rr.M. në kuptim të nenit 173 të KPP-së ka lëshur Urdhër arrest, ku i akuzuari posa të arrestohet të sillet në Gjykatë

Në bazë të Urdhër arrestit të lartë cekur Policia e Kosovës-Stacioni Policor në Ferizaj ka njoftuar se i akuzuari është njoftuar se duhet të paraqitet në Gjykatë ku gjyqtarja e cila është e ngarkuar me këtë lëndë është në pushim vjetor por i njëjti kërkon që të mbahet seanca gjyqësore pasi se të njëjtit i'u është konfiskuar patentë shoferi e pa te nuk mundë që të punoj si vozitës ku për këtë është njoftuar edhe kryetari i Gjykatës ku me datën 26.08.2024 lënda e evidentuar si: 2024:031495 dhe është Ri caktuar te gjyqtari Adem Shabani nga gjyqtarja Hakile Ilazi pasi që lënda tani është me Urdhër arrest.

Të njëjtën datë me 26.08.2024 gjyqtari e njofton edhe prokurorin e shtetit dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me pjesëmarrjen e prokurorit të shtetit Mimoza Sylja Hyseni dhe të akuzuarit Rr.M..

I akuzuari Rr.M., deklaron se i kam kuptuar në tërësi udhëzimet nga ana e gjyqtarit të vetëm gjykues, mbrojtjen do ta paraqes dhe do të deklarohej në lidhje me çështjen do të përgjigjem në pyetjet e gjykatës për mbrojtës nuk kam të angazhuar, mbrojtjen do ta beje vet.

Prokurori i Shtetit Mimoza Sylja Hyseni, i lexon aktakuzën PP/II.nr.1362/2023 të datës 26.01.2024, dhe pas leximit te aktakuzës e pandehuri deklaron: e kam kuptuar në tërësi përmbajtjen e aktakuzës një kopje të saj e kam pranuar si dhe nuk kam nevojë për sqarime të tjera.

Gjyqtari individual pasi që bindet se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë ta pranoj apo të mos pranoj fajësinë.

I pandehuri Rr.M., e pranoj fajësinë për veprën penale për te cilën me ngarkon aktakuza, ku për këtë rast kamë dhënë deklaratë në Prokurorin Themelore në Ferizaj ku më kujtohet se me 06.09.2023 ka qenë kohë e verës, unë kam shkuar tek vendi i quajtur “...” për të marr drunjtë për nevoja familjare e jo për të shitur, me veti kam pasur traktor “Ferguson 39”

dhe te bashkangjitur me rimorkio e cila përdoret për të tërhequr me kafshe-kuaj. Sa isha duke prerë drunjtë, ka ardhur roja e pyllit dhe me ka hasur duke prerë drunjtë, më pyeti “a ki leje për të prerë drunjtë”, unë i tregova që nuk kam dhe ai me njoftoi që do ta paraqes me fletëparaqitje. Unë drunjtë e prerë i kam marr dhe kam vazhduar për në shtëpi, duke u kthyer në shtëpi policia me kanë ndalur në rrugë dhe më kanë dërguar tek pllaci i pylltarisë ku i kam shkarkuar drunjtë dhe kam vazhduar për në shtëpi. E kam ditur se prerja e drunjtëve pa leje është e ndaluar, por meqenëse isha duke i marr vetëm për nevoja familjare e jo për ti shitur, e kam neglizhuar këtë fakt për të cilin tani jam penduar. Aty unë e di që nuk kanë qene me shume se dy metra dru por nuk kam njohuri se si ka arritur kjo sasi e drunjtëve që më faturohet mua. Kjo ka qene hera e pare dhe e fundit që me kanë zënë duke prerë drunjtë dhe e ndjej veten fajtor dhe jam penduar dhe premtoj që në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla.

Pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari Gjykata në kuptim të nenit 242 par.5 të KPP-së, ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), për vlerësimin e pranimit të fajësisë së të pandehurës, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit Mimoza Sylja Hyseni, lidhur me deklarin e të akuzuarit për pranimin e fajësisë ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i akuzuari, ky pranim është bërë vullnetarisht pa presion dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit, kjo ka mbështetje edhe në provat tjera materiale të lëndës, kërkojmë nga gjykata që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë konform ligjit duke pas parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe me sanksionin e shqiptuar të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjyqtari vetëm gjykues, pas deklarin e të akuzuarit për akuzën që i ngarkohet, dhe mendimit të prokurorit të shtetit rreth pranimit të fajësisë, ka marrë aktvendim me anë të cilit ka pranuar deklarin e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për veprën penale që ngarkohet sikurse në aktakuzë, duke vlerësuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë sipas nenit 242 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK) 08/L-032, gjyqtari ka vlerësuar se i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi bëhet vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartëligjore ose gabime faktike.

Duke u bazuar në deklarin e të akuzuarit për ta pranuar fajësinë në tërësi për të gjitha pikat e aktakuzës, gjykata nuk administroi me provat në këtë çështje penale juridike, pasi që gjykata ka vërtetuar këtë gjendje të pa kontestuar faktike se i akuzuari veprën penale që akuzohet siç është e përshkruar në dispozitiv të Aktgjykimit e ka kryer.

Gjendjen e tillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe nga provat dhe faktet e pa kontestueshme që i përmban aktakuza, siç janë: - Deklarata e të pandehurit Rr.M., të dhënë në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, më datë 15.01.2024, - Fletëparaqitja e rojës se pyllit e përpiluar nga Rr.U. me nr. ..., i dt.22.09.2023,- Procesverbali i përpiluar nga komisioni i eksperteve të pylltarisë me numër .../23, dt. 22.09.2023; dhe Pesë fotografi të formatit A4 me fotot të bëra në vendin e ngjarjes.

*Gjykata ka vlerësuar dhe konstatuar se nga veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementete veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së.*

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese ka gjetur se i akuzuari e ka pranuar fajësisë dhe rrethanat personale se është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, është mbajtës i vetëm i familjes, baba i një fëmije ndërsa si rrethanë rënduese gjykata merr për bazë rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe përgjegjësinë penale e të pandehurit ,andaj, në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtui të akuzuarit, i cili do ta kuptoj rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është sjellë në bazë të nenit 462 të KPPRK-së.

Vendimi mbi pagesën e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr në kuptim të dispozitës së nenit 449 paragrafi 2 nën par 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 449 paragrafi 2 nën par 2.9 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

**2024:0311495 me datë 27.08.2024**

**Zyrtare Ligjore**

Arbelinda Tahiri

**Gjyqtari,**

Adem Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.